



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr.11
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10
Prishtinë, më 12 gusht 2021, në orën 09:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Miljana Nikoliq, Labinotë Demi-Murtezi, Haxhi Avdyli, Burim Karameta, dhe Bekim Haxhiu, anëtarë.

Munguan : Mirsad Shkreta, Shemsedin Dreshaj, Uran Ismaili dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Stafi mbështetës: Besim Haliti, zyrtar i lartë i fushës/analist.

Pjesëmarrës të tjerë: Violeta Salihu, KShMS.

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Përmbyllja e sesionit pranveror dhe përgatitja për sesionin vjeshtor, me thekës të veçantë për mirëqenien sociale;**
3. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Fatmire Kollçaku, tha se ky është një takim përmbyllës, sa i përket sesionit pranveror. Lidhur me këtë, stafi i komisionit e ka përgatitur një draft-raport të punës për sesionin pranveror, që është në formë të njoftimit, ku është paraqitur e gjithë puna dhe aktivitetet e komisionit gjatë kësaj periudhe.

Ajo theksoi se sesioni pranveror nuk është i plotë, kur dihet se sesionin pranveror ka filluar me fillimin e legjislaturës së re, ku mbledhja e parë e komisionit për vitin 2021 është mbajtur më datë 13 prill 2021, andaj për këtë periudhë është pasqyruar raporti i punës si në vijim: Komisioni ka mbajtur gjithsej, deri më tani, 11 mbledhje. Gjatë kësaj periudhë ka shqyrtuar 1 (një) projektligj e që është Projektligji për amendamentimin 02 të Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim KSV/017:Programi për mbështetje shëndetësore (pjesa II), ka shqyrtuar 4 shkresa të institucioneve publike dhe private, i ka adresuar 3 shkresa për institucione tjera dhe në periudhën raportuese, është duke monitoruar 2 ligje: Ligjin 05/L-025 për shëndetin mendor dhe Ligjin 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19 në territorin e Republikës së Kosovës. Ndërsa, sa përket përgatitjes për sesionin vjeshtor, me thekës të veçantë, për mirëqenien sociale, ajo theksoi se në fokus do t'i kemi projektligjet që priten të sillen nga Qeveria apo ministra përkatëse. Po ashtu, do t'i trajtojmë edhe temat dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fushën e mirëqenies sociale dhe për këtë çështje do ta ftojme ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Muratin, për të na njoftuar për projektligjet që priten të sillen nga kjo ministri, në komision. Ajo tha se meqenëse situata me pandeminë COVID -19 ka filluar të rëndohet, propozoi që t'i shtohet kësaj pike të rendit të ditës, diskutimi për situatën aktuale me pandeminë COVID -19.

Bekim Haxhiu, lidhur me propozimin që të diskutohet për situatën e pandemisë, tha se në debat duhet të ishin përgjegjësit që merren më menaxhimin e pandemisë, për të na informuar me situatën aktuale, sepse situata po shkon drejt përkeqësimit dhe gjendja me pandeminë COVID -19, ka filluar të keqësohet, prandaj është dashur që sot, t'i kemi të ftuar përgjegjësit e Ministrisë së Shëndetësisë, për të raportuar mbi gjendjen e renduar që po përballemi këto ditë nga përhapja e shpejtë dhe e madhe e pandemisë COVID-19. Ndërsa, sa i përket sesionit pranveror, tha se është dështimi total i Qeverisë, pasi që nuk i ka sjellë projektligjet që i ka pasur të parapara në programin legjislativ dhe këtu në raportin e punës së komisionit, është paraqitur vetëm puna dhe aktivitetet që i ka pasur vet komisioni, me iniciativat e veta.

Fatmire Kollçaku, lidhur me fushëveprimin i mirëqenies sociale, tha se fillimisht me formimin e Komisionit, nuk na ka takuar, por pas kërkesës së komisionit, drejtuar Kryesisë së Kuvendit dhe insistimit të vazhdueshme tonë dhe me pajtim të të gjitha grupeve parlamentare në seancën e plenare të Kuvendit, ky fushëveprimi i është shtuar komisionit, ka fundi i përfundimit të sesionit pranveror, andaj dhe për këtë arsye nuk kemi pasur mundësi të merret me fushën e mirëqenies sociale dhe për këtë fushëveprim do të fokusohemi më shumë në sesionin vjeshtor. Lidhur me situatën aktuale të pandemisë, siç dini për një periudhë, kemi pasur një gjendje të mirë pothuaj në rënie të plotë të numrit të infektuar me virusin COVID -19, por në ndërkohë ka pasur rritje të theksuara dhe në këtë situatë, kemi interesim më madh për vaksinim kundër pandemisë COVID -19, ku është në rritje numri i të vaksinuarave dhe vaksina ka të mjaftueshme, por duhet të bëhet edhe një sensibilizim më i madh nga të gjitha institucionet shtetërore, që të kryhet sa më shpjet vaksinimi dhe ta kemi një vaksinim sa më masiv të qytetarëve, në mënyrë që të ketë parandalim të përhapjes së epidemisë me COVID -19.

Bekim Haxhiu, ajo që mbetet brengose është përhapja e shpejtë e pandemisë COVID -19, me variantin e quajtur "Delta" dhe është për t'u shqetësuar, për numrin e vogël të qytetarëve që janë të vaksinuar, derisa vikendeve nuk është punuar dhe Qeveria ka proklamuar vazhdimisht se do të bëhet vaksinimi masiv i popullatës, por që kjo gjë nuk është bërë deri më tani. Ai tha se nuk kanë informata nga MSH-ja për numrin e vaksinave kundër COVID -19, se sa janë në stoqe, sikur ta

kishim këtë informatë, sigurisht edhe qytetarët ishin ndier më sigurt. Ai potencoi se tani edhe marrja e masave është problematike, sepse është diskriminim për qytetarët që janë vaksinuar, sensibilizimi është dashur të rritet, që nga fillimi i dhënies së vaksinës, andaj duhet që të kemi fushatë sensibilizuese, duke i angazhuar profesionistët shëndetësorë të epidemisë, për marrje të vaksinës kundër COVID -19, prandaj MSH duhet ta rishikojë mënyrën e procesit të përshejtimin për dhënie të vaksinës.

Fatmire Kollçaku, tha se e përkrah idenë për angazhimin e profesionistëve të epidemisë në promovimin e fushatës sensibilizuese, për t'u vaksinuar kundër pandemisë COVID-19 dhe për këtë çështje duhet të avokojmë të gjithë aktorët që kanë ndikim në shoqëri, se dy vaksinat që janë në Kosovë "Pfizer" dhe "AstraZeneca" janë të certifikuara dhe janë të sigurta.

Haxhi Avdyli, lidhur me dhënien e vaksinave kundër pandemisë COVID-19, tha se ritmi i deritanishëm nuk është i kënaqshëm, ndërsa sa i përket rritjes së rasteve të infektuarave me variantin "Delta", ky është një trend botëror që po ndodh e jo vetëm te ne. Kërkoj që të bëhet një kërkesë MSH-së, që procesi i dhënies së vaksinave të përshejtohet duke filluar dhe gjatë ditëve të vikendeve, në mënyrë që qytetarëve t'ju mundësohet dhënia vaksinave dhe këtyre ditëve edhe procesi të mos ndërpritet.

Fatmire Kollçaku, propozoi që për këtë çështje t'i dërgohet një kërkesë Ministrisë së Shëndetësisë, të na dërgojë një raport me shkrim, me qëllim të informimit nga afër me masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID- 19, se cilat janë masat që po ndërmerrni lidhur me situatën e krijuar dhe çka po planifikoni që të ndërmerrni në të ardhmen e afërt, pasi që ditëve të fundit e kemi një trend të rritjes së shpejt të rasteve pozitive. Qeveria e Republikës së Kosovës, a do të ndërmarrë edhe masa tjera, lidhur me këtë çështje? Po ashtu, të kërkohet nga Ministria e Shëndetësisë, që ta intensifikojë procesin e vaksinimit, sa më shumë që është mundur, në mënyrë që të ketë parandalim të përhapjes së pandemisë COVID -19.

Komisioni e përkrahu propozimin e znj. Kollçaku.

3.Të ndryshme

Fatmire Kollçaku, tha se në sesionin vjeshtor, duhet të vazhdojmë punën e monitorimit të dy ligjeve, pas tërheqjes në mbledhjen e fundit të komisionit, të kryesuesit të grupit punues për monitorimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19 në territorin e Republikës së Kosovës, të deputetit Bekim Haxhiu, atëherë këtë grup të punës duhet ta kryesojë dikush nga anëtarët e grupit punues.

Labinotë Demi- Murtezi, propozoi që kryesimin e grupit të punës për monitorimin e Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, në territorin e Republikës së Kosovës, ta bëjë anëtari sipas radhës që është në bazë të vendimit të komisionit, si zëvendësim, që në këtë rast është znj. Fatmire Kollçaku.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti: Staf mbështetës i Komisionit.

Fatmire Kollçaku,
Kryetare e Komisionit

